

Termt e Referencës

Ekspert/e për hartimin e Strategjisë dhe Planit trevjeçar të punës (2022-2025) për grupin monitorues të fëmijëve Respect Our Rights - ROR

Hyrje

Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si organizatë joqeveritare lokale në shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë edhe më herët, që nga viti 1999, si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës. Që nga fillimi, motoja e organizatës ka qenë “Mendo globalisht, vepro lokalisht”, të cilës organizata i ka qëndruar besnike. Misioni i organizatës është “Zhvillimi i komunitetit të njerëzve, grupeve joformale, organizatave, rrjeteve, institucioneve dhe donatorëve përmes avokimit, shkëmbimit të informacionit dhe ndërgjegjësimit” dhe SiV përmes veprimit të saj dëshmon se është një organizatë që kryen veprime lokale bazuar në praktikat më të mira.

II. Informata të përgjithshme

Syri i Vizionit (SiV) në partneritet me Save the Children zyra në Kosovë (SCiK), tash e disa vite është duke punuar në programe për monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë të cilat kanë për qëllim respektimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, në kuadër të të cilave ka zhvilluar projekte për të fuqizuar mekanizmat e parandalimit të dhunës, ndëshkimit trupor dhe raportimit të rasteve të dhunës në shkollat e komunave Pejë, Klinë, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë.

Në kuadër të programit tematik në fushën e mbrojtjes dhe qeverisjes me të drejtat e fëmijëve “Detyrimi ynë për të Ardhmen - Mbrojtja e Fëmijës dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijës”, po punohet në parandalimin e dhunës dhe ndëshkimit trupor ndaj fëmijëve në çdo ambient; krijimin e mekanizmave apo instrumenteve miqësore dhe të besueshme ndaj fëmijëve për të raportuar rastet e dhunës në shkollë; fuqizimin e grupeve të fëmijëve përmes Asambleve Komunale të Fëmijëve-AKF dhe Grupin Monitorues Respect Our Rights-ROR, në fushën e të drejtave dhe përfshirjen aktive të tyre në vendimmarrje në nivel lokal dhe nacional.

Pjesë e rëndësishme e programit është ngritja e kapaciteteve, fuqizimi dhe zhvillimi i grupit të fëmijëve ROR në monitorimin e zbatimit të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat e

Fëmijëve në Kosovë dhe mbrojtjen e interesit me të mirë ë fëmijës duke i bërë pjesë të proceseve dhe politikave vendimmarrëse .

III. Objektivi

Syri i Vizionit kërkon të angazhojë një ekspert/e- profesionist/e (në fushën përkatëse) për hartimin e strategjisë dhe planit të punës për zhvillimin, fuqizimin dhe qëndrueshmërinë e grupit ROR. Strategjia dhe plani i punës trevjeçar do të përcaktojë objektivat e zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së grupit duke u mbështetur në nevojat, mundësitë dhe kapacitetet ekzistuese që tashmë ka ROR-i.

IV. Kualifikimi i nevojshëm:

- Diplomë universitare (kualifikimi master dhe edukimi profesional/joformal në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe vendimmarrje është përparësi);
- Dokumentimi i përvojës së punës në hartimin e strategjive apo planeve të punës dhe raporteve të nxjerra nga hulumtimet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrje;
- Njohuri për parimet e të drejtave të fëmijëve të bazuara në KDF dhe KB;
- Njohuri mbi sistemin e arsimit në Kosovë me theks të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre në shkollë;
- Shkathtësi të shkëlqyera analitike, udhëheqëse dhe shkathtësi në shkrim e komunikim;
- Shkathtësi të mira në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe dhe angleze.

V. Detyrat dhe përgjegjësitë:

Nga eksperti/ja i/e angazhuar pritet:

- Përgatitja e planit të punës dhe metodologjisë, draft-agjendën dhe zhvillimi i materialeve të nevojshme për punëtorinë me fëmijë;
- Udhëheqja e punëtorisë treditore me fëmijët e grupit ROR dhe mentorët (si dhe përfaqësues nga SiV dhe SCiK) dhe hartimi i draftit të parë të strategjisë dhe planit të punës me rekomandimet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve;
- Dorëzimi i draftit të parë të strategjisë tek SiV, jo më vonë se shtatë (7) ditë pas mbajtjes së punëtorisë për rishikim nga SiV dhe SCiK si dhe mentorët e grupit;

- Dorëzimi i dokumentit final/Strategjisë për aprovim tek SiV jo më vonë se tre (3) ditë pune pas pranimit të komenteve;
- Dorëzimi i raportit me shkrim tek SiV jo më vonë se pesë (5) ditë pune pasi të ketë dorëzuar dokumentin final/strategjinë e miratuar nga SiV dhe SCiK.

VI. Angazhimi i ekspertit/es:

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me Syri i Vizionit - nën koordinimin e Menaxherit të Financave dhe Administratës. Në këtë kontratë do të përcaktohen në mënyrë specifike pikat të cilat nuk janë të përfshira në këtë dokument. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit korrik në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyrat	Kohëzgjatja
Familjarizimi me punën, dokumentet dhe raportet e Grupit ROR dhe përgatitja e metodologjisë së punës për punëtorin (Metodologjia, agjenda dhe materialet tjera të nevojshme)	1 ditë
Mbajtja e punëtorisë për hartimin e strategjisë me fëmijët e grupit ROR dhe mentorët, <i>përcaktimi i objektivave dhe aktiviteve</i> duke u bazuar në nevojat dhe propozimet që dalin nga vetë pjesëmarrësit si vijon: <ul style="list-style-type: none"> - Qëllimi; - Objektivat; - Aktivitetet; - Rezultatet e pritura; - Indikatorët - Monitorimi dhe vlerësimi i planit të punës 	3 ditë
Hartimi dhe finalizimi i Strategjisë	1/2 ditë
Përgatitja dhe dorëzimi i raportit narrativ	1/2 ditë
Gjithsej:	5 ditë

VII. Kushtet e pagesës:

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, e cila do të lëshohet nga ai/ajo ose do të përgatitet nga SiV e do nënshkruhet nga Eksperti/ja. Pagesa do të realizohet përmes transaksionit bankar në valutën euro. Pagesa do të bëhet pas përfundimit me sukses të punëtorisë dhe dorëzimit të dokumentit final/Strategjisë dhe raportit narrativ të miratuar nga SiV.

Në bazë të ligjit të Kosovës, Syri i Vizionit është po ashtu e obliguar që të paguajë tatimin (taksa dhe pension) prej 10% të shumës bruto. Shpenzimet e ushqimit gjatë punëtorisë do t'i mbulojë organizatori.

VIII. Dokumentet e kërkuara dhe procedura për aplikim:

1. Metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e mbajtjes së punëtorisë dhe hartimin e strategjisë e planin e punës (2022-2025);
2. Një letër interesimi që paraqet arsyet që ai/ajo është i/e përshtatshëm dhe ka njohuri dhe përvojë në këtë fushë apo fusha të ngjashme;
3. Diplomë Universitare e cila dëshmon kualifikimin e tij/saj;
4. Curriculum Vitae (CV);
5. Propozimi financiar*

**Oferta financiare duhet të jetë e hollësishme për secilën punë që do të realizohet, duke përfshirë, zhvillimin e modulit dhe materialet e trajnimit, mbajtjen e trajnimeve dhe shkrimin e raportit.*

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: office@syriivizionit.org ose info@syriivizionit.org me subjektin: Aplikacioni për Hartimin e Strategjisë dhe planit të punës së ROR-it. **Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është data: 09 korrik 2021, ora 17:00.**

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!